

## **KONTRATE PAJTIMI PER SHERBIMIN E INTERNETIT**

Date: \_\_\_\_\_

Nr: \_\_\_\_\_

### **INFORMACION PER PALET**

#### **Te dhenat e Ofruesit te Sherbimit**

Soft & Solution  
Adresa: Rruga Hoxha Tahsin, Nd.113, H.1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017  
Kodi Postar 1001, Tirane  
Cel: +355 67 600 66 33  
Email: [contact@softsolution.al](mailto:contact@softsolution.al); web: [www.softsolution.al](http://www.softsolution.al)

#### **Te dhenat e Pajtimtarit**

Emer  
Mbiemer:  
Nr. Personal:  
Adresa:  
Tel.:  
Cel.:  
Email:

### **KUSHTET E KONTRATES**

#### **Objekti**

Kjo kontrate percakton kushtet, afatet, te drejtat dhe detyrimet qe palet do te kene kundrejt njera-tjetres si rrjedhoje e perdorimit nga Pajtimtari te sherbimit te ofruar nga Ofruesi i Sherbimit, Sherbim quhet lidhja ne rrjetin e Ofruesit te sherbimit te Pajtimtarit qe kerkon ofrimin e sherbimi, duke u bazuar ne kete kontrate. Data e fillimit te Sherbimitt eshte data e aktivizimit te tij nga Ofruesi i Sherbimit. Aktivizimi i Sherbimit do te kryhet brenda 4-5 diteve pune nga data e pagimit te tarifes se Sherbimit

#### **Kohezgjatja**

Kjo kontrate lidhet per nje afat te percaktuar sipas llojit te kontrates. Kontrata rinovohet automatikisht per te njejten periudhe e me te njejtat kushte ne mungese te njoftimit paraprak 20 ditor nga perfundimi i afatit per mosrinovimin e saj nga secila pale.

#### **Menyra e Pageses**

Pajtimtari mund te paguaje vleren e plote te sherbimit ne momentin e lidhjes se kontrates ose te paguaje sherbimin cdo muaj. Kur Pajtimtari zgjedh te paguaje sherbimin ne baze mujore, Pajtimtari bie dakord qe te kryeje pagesen vijuese mujore Brenda 7 diteve perpara dates se perfundimit te sherbimit te paguar. Ofruesit te Sherbimit i lind e drejta e nderprerjes se sherbimit te ofruar sipas kesaj Kontrate nese Pajtimtari nuk permbush detyrimin e parashikuar ne kete paragraf. Pajtimtari mund t'i kryeje pagesat e percaktuara mesiper me leke ne dore "cash" prane zyres se shitjeve te Ofruesit te Sherbimit ose me transferte bankare ne numrat e llogarise bankare te Ofruesit te Sherbimit, te shenuara ne faturen mujore perkatese.

## **Te Drejtat dhe Detyrimet e Ofruesit te Sherbimit**

### **Ofruesi i Sherbimit:**

Siguron menyren dhe infrastrukturat teknikeper vijimin e aksesit te komunikimeve elektronike nga pika e lidhjes se tij lokale deri tek nyja me e afert shperndarese prane Pajtimtarit ne adresen e dhene, si dhe e lidhe Pajtimtarin me rrjetin e tij brenda mundesive aktuale teknike duke vene ne dispozicion te tij pajisjet perkatese. Instalon dhe konfiguron Sherbimin e Internetit pasi Pajtimtari ka kryer paqesen per instalim dhe konfigurim, brenda 5 (pese) diteve nga nenshkrimi i kontrates per Sherbimin e Internetit. Pajtimtari kryen aksesin ne sistemet dhe rrjetet e tjera nga interneti, nepermiet lidhjesse ofruar nga Ofruesi i Sherbimit te Internetit ne perputhje me rregullat e vendosura nga pronaret e sistemeve dhe rrjeteve te tjera, ne perputhje me ligjet nderkombetare, si dhe nga rregulloret specifike ligjore te vendit qe ka ne pronesi sistemet dhe rrjetet, si dhe te atyre ku ndodhen fizikisht keto sisteme. Gjithashtu pergjigjet per cilesine e mirete sinjalit te transmetimit dhe mirembane pajisjet dhe aparaturat qe ofrojne aksesin brenda standardeve dhe normativave teknike. Garanton cilesine e rrjetit te komunikimit elektronik dhe aplikon ne perputhje me politikat e biznesit tarifen e pajtimit mujor.

Leshon faturen perkatese per Pajtimtarin, ku pasqyrohet shuma ne vlere monetare qe Pajtimtari duhet t'i paguaje Ofruesit te Sherbimit.

Per qellime mirembajtjeje ose per shkak te forcave madhore, Ofruesi Sherbimit ka te drejte dhe mund te nderprese aksesin e komunikimeve elektronike ne menyre te njeanshme. Ne kete rast, Ofruesi i Sherbimit eshte i detyruar te njoftoje Pajtimtarin, per nderprerje qe zgjasin me pak se 30 (tridhjete) minuta, te pakten 1 (nje) dite para nderprerjes dhe tembaje ne minimum kohezgjatjen e nderprerjes por jo me shume se 1 (nje) dite ne rastet e problemeve te infrastruktures se Ofruesit te Sherbimit. Ne rast se problemi zgjat me shume se 3 (tre) dite nga momenti i njoftimit te problemit Pajtimtari kerkon nderprerje te kontrates, Ofruesi i Sherbimit eshte i detyruar te llogarise pagesen deri ne momentin qe Pajtimtari ka perdorur Sherbimin objekt kontrate.

Ka te drejte te nderprese apo kufizojte perkohesisht aksesin ne Sherbimin e ofruar per permiresim, modernizim, mirembajtje apo per probleme teknike te rrjetit. Per kufizime apo nderprerje, te cilat zgjasin me shume se 30 (tridhjete) minuta, Ofruesi i Sherbimit do te njoftoje AKEP, kur eshte rasti i specifikes se Sherbimit, dhe Pajtimtarin te pakten 48 (dyzet e tete) ore me perpara ne rast te nje modernizimi, permiresimi ose mirembajtje te planifikuar te rrjetit, sa me shpejt qe te jete e mundur, por jo me vone se 48 (dyzet e tete) ore pas ndodhjes se kufizimit apo nderprerjes se shkaktuar nga defektet apo demtimet e rrjetit.

Ka te drejte ne bashkepunim me perfaqesuseit e Pajtimtarit te kryje kontrole per perdorimin e linjes se ofruar nga Ofruesi i Sherbimit.

Ka te drejte te zgjidhe kontrates dhe te nderprese Sherbimin ne rast se Pajtimtari nuk ploteson detyrimet e tij ne rast te sulmeve dhe virusimeve te ndryshme ne rrjetin e tij.

Per Sherbimin e ofruar do te shqyrtoje me perparesi kerkesen e Pajtimtarit per transferim eventual te banimit te tij brenda rrjetit lokal, nese do te ekzistojne mundesite teknike per kryerjen e transferimit ne fjale; riparoje defektet dhe rivendose funksionimin e rrjetit brenda 7 (shtate) diteve nga data e marrjes se njoftimit nga Pajtimtari per defektet e zakonshme dhe brenda nje periudhe kohore me te gjate ne rastin e defekteve me te renda.

Ne asnje rast apo rrethane, Pajtimtari nuk ka te drejte te kerkoje kthimin e paqeses qe ka kryer per Sherbimin. Perte shmangur cdo paqartesi, nese Pajtimtari nderpret kontraten apo terhiqet nga marrja e Sherbimit, per cfaredolloj arsye, pagesa e kryer nuk kthehet. Pajtimtari do te informohet paraprakisht nga Ofruesi i Sherbimit per nderprerjet eplanifikuara per mirembajtjen e rrjetit, duke mos qene i detyruar te paguaje ndonje tarife pajtimi mujor apo tarife tjeter per perdorimin e sherbimit, gjate periudhes se pezullimit te sherbimit. Kohezgjatja totale e periudhes se pezullimit nuk mund te jete me e madhe se 3 (tre) dite dhe jo me shume se 2 (dy) here gjate vitit kalendarik. Pajtimtarit i njihet e drejta e kompensimit te detyrimit te tij ndaj Ofruesit te Sherbimit, me te drejtat qe Pajtimtari ka kundrejt Ofruesit te Sherbimit.

### **Te Drejtat dhe Detyrimet e Pajtimtarit**

Ofruesi i Sherbimit i jep ne perdorim Pajtimtarit kundrejt pajisjet pa paqese/shperblim me kushtin e lidhjes se kontartes jo me pak se nje periudhe 3 (tre) mujore pergjate gjithë kohezgjatjes se kontrates. Gjate kohezgjatjes se kontrates por edhe pas perfundimit te saj, pajisjet do te mbeten ne pronesi te Ofruesit te Sherbimit dhe do t'i kthehen Ofruesit te Sherbimit ne momentin e perfundimit ose zgjidhjes perpara afatit te kesaj kontrate. Pajtimtari mund te kerkoje ne cdo kohe gjate kohezgjatjes se kontrates ndryshime te karakterit teknik, kur eshte rasti i sherbimit specifik, per te cilat bihet dakort midis paleve. Ne nje rast te tille palet do te

nenshkruajne nje shtojce kontrate. Pajtimtari kontakton Ofruesin e Sherbimit per problemet nepermjet numrave te kontaktit ose emailit te percaktuara ne kete kontrate, Ne raste te problemeve ne ofrimin e Sherbimit e Internetit objekt kontrate per me shume se 3 (tre) dite, nga data e njoftimit te tyre Pajtimtari mund te kerkoje nderprerjen e kontrates:

Pajtimtari do te perdore Sherbimin, objekt kontrate, vetem per nevojat e tij dhe nuk mund, ne asnje menyre, forme apo rrethane, ta shese kete Sherbim apo t'ja jape aksesin nje tjetri, dhe as te lejoje lidhje paralele apo te tjetersoje objektin e ketij pa pelqimin e Ofruesit te Sherbimit.

Pajtimtari mundeson energji elektrike per te gjithapajisjet e Ofruesit te Sherbimit qe jane te nevojshme per ofrimin e Sherbimit e qe instalohen ne ambjentet e tij. Pajtimtari eshte i detyruar to demshperbleje Ofruesin e Sherbimit per cdo dem te shkaktuar pajisjeve te tij si rezultat i keqperdorimit dhe kushteve te papershtateshme te ambjenteve te tij. Pajtimtari eshte pergjegjes per sigurimin, ruajtjen dhe perdorimin e sigurt te pajisjeve pas instalimit.

Pajtimtari pranon qe Ofruesi i Sherbimit nuk mund te jete pergjegjes per cdo kosto ose demtim qe mund te vije si rezultat i perdorimit te internetit, ose i sistemeve dhe rrjeteve te tjera perfshire ketu dhe humbje te te dhenave te shkaktuara nga vonesa, mosdergim ne destinacion, transferime te gabuara, nderprerje dhe/ose nga arsye teknike, teknologjike te tjera.

### **Perdorimi, garancia dhe detyrime te vecanta per Sherbimin**

Ofruesi i Sherbimit i jep pajisjen ne perdorim kundrejt pageses se nje kontrate me kohezgjatje jo me te vogel se 3(tre) mujore, qe paguhet plotesisht ne momentin e lidhjes se kontrates, dhe eshte e vlefshme pergjate gjithe kohezgjatjes se kontrates. Gjate kohezgjatjes se kontrates por edhe pas perfundimit te saj, pajisjet do te mbeten ne pronesi te Ofruesit te Sherbimit dhe do t'i kthehen Ofruesit te Sherbimit ne momentin e perfundimit ose zgjidhjes se kesaj kontrate.

Pajtimtari do te perdore pajisjet vetem per qellimin qe i jane dhene ne perdorim nga Ofruesi i Sherbimit duke respektuar te gjitha kushtet e perdorimit le pajisjeve, si dhe do te siguroje qe pajisjet te funksionojne brenda kushteve teknike te kerkuara. Te ruaje pajisjet nga demtime te ndryshme qe mund t'i ndodhin si pasoje e ndryshimeve ne rrymen elektrike, nga demtime qe mund t'i shkaktohen nga faktorete tjere atmosferike. Gjithashtu nuk duhet te lejoje nderhyrje te paautorizuar nga Ofruesi i Sherbimit nga persona te trete ne pajisjet e ofruara nga Ofruesi, ne te kundert Pajtimtari do te paguaje vleren e plote te pajisjes.

Ne rast se ne momentin e perfundimit ose zgjidhjes se kontrates pajisjet jane jashte perdorimit per shkak se Pajtimtari nuk ka respektuar kushtet e parashikuara ne kete kontrate ky i fundit, do te paguaje vleren e plote te pajisjeve te paraqitur nga Ofruesi i Sherbimit.

Ne rast te konstatimit te defekteve, Pajtimtari do te njoftoje menjehere Ofruesin e Sherbimit, te vetmit persona qe mund le hapin dhe te kryejne nderhyrje ne pajisje jane personat e autorizuar nga Ofruesi i Sherbimit.

Nese Pajtimtari nuk kthen pajisen brenda afatit 2 mujor pas perfundimit ose zgjidhjes te kesaj kontrate, Ofruesi i Sherbimit ngarkon Pajtimtarin me nje penalitet deri ne 2-fishin vleres se pajisjes.

### **Zgjidhja e Mosmarveshjeve**

Ankesat e Pajtimtarit te lidhura me shumen e faturuar per sherbimin e ofruar apo me cilesine e sherbimit te ofruar i derqohen Ofruesit te Sherbimit brenda 15 (pesembedhete) diteve nga marrja e fatures apo nga ofrimi i sherbimit. Ofruesi i Sherbimit detyrohet tetrajtoje ankesen brenda 15 (pesembedhete) diteve kalendarike te marrjes se saj me pergjegjesi ligjore dhe te argumentoje me fakte dhe referenca ligjore qendrimin e mbajtur ne pergjigje te ankimit. Mjetet e komunikimit te Pajtimtarit dhe Ofruesit te Sherbimit jane: Poste, Email.

Pajtimtari nese nuk bie dakort me pergjigjen me shkrim te Ofruesit te Sherbimit ka te drejte te filloje nje procedure per zgjidhjen e mosmarveshjes duke iu drejtuar: a)AKEPit sipas rregullave te percaktuara ne ligjin nr. 9918 dhe Rregullores Nr.29; ose b) Gjykates kompetente sipas Kodit te Procedures Civile.

Ankesa duhet te permbaje nje perskrim te sakte te gjithe rrethanave nenskrimin e ankuesit. Ankesa e plotesuar nuk do te cliroje pajtimtarin i takon. qe kane cuar ne berjen e ankeses dhe nga detyrimi per te paguar shumen qe

### **Zgjidhja e Kontrates**

Ne rast moszbatimi nga ana e Pajtimtarit te detyrimeve te percaktuara ne kete kontrate, Ofruesi i Sherbimit ka te drejtet'i nderprese Pajtimtarit Sherbimin dhe te zgjidhe kete kontrate duke kerkuar demshperblimin perkates.

Ofruesi i Sherbimit ka te drejte qe ne cdo moment te zgjidhe kontraten ne menyre te menjehershme per shkaqet e arsyeshme, te tilla si: atak abuziv, hackerim, shperndarje programesh pornografike etj., duke i kerkuar Pajtimtarit te plotesoje te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Sherbimi.

### **Njoftimet**

Te gjitha njoftimet sipas kesaj kontrate duhet te behen me shkrim dhe t'i derqohen pales perkatese ne adresen e treguar ne kete kontrate ose ne adrese tjeter qe mund te jete komunikuar me shkrim nga pala. Njoftimet derqohen tek personi i kontaktit i percaktuar ne kete kontrate per secilen pale, dorazi, me poste te rregjistruar ose email apo cdo menyre tjeter e cila provon vertetimin e marrjes se njoftimit.

Pajtimtari pranon te mare njoftime nga Ofruesi i Sherbimit ne menyre periodike ne lidhje me mbarimin e sherbimit dhe ofertat e reja nepermejet SMS, E-mail dhe thirrjeve telefonike. Me qellim te zbatimit te ketij parashikimi, Pajtimtari deklaron dhe pranon qe do te perditesoje te dhenat e deklaruarra prej tij. ne rast se gjate kohezgjatjes se kontrates, keto te dhena ndryshojne.

### **Juridiksioni**

Kjo kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar. Mosmarveshjet qe mund te rrjedhin nga kjo kontrate do te zgjidhen ne mirekuptim mes paleve. Ne rast se palet nuk do te arrijne ne marveshje, konflikti do t'i nenshtrohet per shqyrtim Gjykates se Tiranes.

### **Afati dhe Iloji i Kontrates**

#### **Te dhenat e kontaktit ne dispozicion te Pajtimtarit**

Email: [contact@softsolution.al](mailto:contact@softsolution.al)

Mobile: +355 67 600 66 33

**Soft & Solution**  
Administrator

**PAJTIMTARI**  
Jam dakord me kushtet e Kontrates